



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033 421210; Fax 033 421205 E-mail: info@bashkiavlore.org

Nr. 496 prot.

Vlorë me 06.02 2015



“DHËNIE ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK
PRIVAT TE SHERBIMIT TE SISTEMIMIT DHE
MENAXHIMIT TE PARKIMIT NE QYTETIN E
VLORES”

KONTRATË KONCENSIONI

Lidhur në Vlorë, sot më 06/02/2015, midis:

- **Bashkia Vlorë**, që me poshtë do të quhet **“AUTORITETI KONTRAKTUES”**, përfaqësuar nga Kryetari, z. Shpëtim Gjika.

dhe

- **Bashkimi i përkohshëm i shoqërive**, që ne vijim do të quhet **“KONCESIONARI”**, i krijuar me “Kontratën për krijimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive”, datë 04.01.2015, i përbërë nga:
 1. **Shoqëria TIS Holding LLC**, shoqëri e regjistruar në Delaware, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me nr. identifikimi dhe të TVSH-së 52914-00, përfaqësuar nga z. Bashkim Shalla, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë.
 2. **Shoqëria On Track Innovations LTD**, shoqëri e regjistruar në Rosh Pina, Izrael, me nr. identifikimi dhe të TVSH-së 520042862, përfaqësuar me prokurë, si dhe në cilësinë e tij të përfaqësuesit të shoqërisë kryesuese të bashkimit të përkohshëm të shoqërive nga z. Bashkim Shalla.

KUSHTE PARAPRAKE

Duke konsideruar që:

- Në përputhje me ligjin nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për Koncesionet dhe partneritetin publik privat” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Autoriteti Kontraktues ka ftuar ofertuesit më datë 19.12.2014 të paraqesin ofertat e tyre për marrjen me koncesion/partneritet publik privat, të shërbimit të sistemimit dhe menaxhimit të parkimit



në Qytetin e Vlores, i shtrirë në një listë rrugësh të përcaktuara në dokumentet e procedurës konkurruese, referuar në vijim si "projekti".

- Koncensionari paraqiti një ofertë për Projektin më datë 12.01.2015, bashkëngjitur kësaj kontrate si aneksi "Oferta e koncesionarit";
- Autoriteti kontraktues në përmbyllje të procedurës së vlerësimit të ofertave, shpalli Koncensionarin fitues të procedurës konkurruese.

Palët kanë negociuar kushtet e kësaj kontrate koncesioni, dëshirojnë të lidhin atë duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet respektive si vijon:

NENI 1

Përkufizime

Kurdoherë që përdoren në këtë Kontratë (duke përfshirë Anekset e saj), për sa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

"Kontratë" do të thotë kjo Kontratë Koncesioni përfshirë të gjithë Anekset e saj, si dhe dokumentacionin e procedurës konkurruese dhe ofertën e koncesionarit, dokumente, të cilët konsiderohen se përbëjnë pjesë integrale e të pandashme të saj. Për të shmangur çdo paqartësi kontratë do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit që përbëhet nga dokumentat e procedurës konkurruese, duke përfshirë KPK dhe KVK, DSPK, ofertën e koncesionarit, dokumentacionin teknik, shtojcat vizatimet, projektin, plan biznesin dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.



"**Autorizime**" nënkupton çdo miratim, leje, licencë, autorizim, miratim, certifikatën, akt tjetër administrativ që akordon të drejta, lëshimi ose rinovimi i të cilave është përgjegjësi e çdo organi administrativ të administratës shtetërore, qendrore dhe/ose lokale dhe që është i nevojshëm për zbatimin e kësaj kontrate nga koncesionari.

"**Rregulla dhe Norma të Zbatueshme**" janë normat me karakter teknik, për shëndetin dhe sigurinë, të ndërtimit, të mbrojtjes së ambientit, si dhe të tjera të përcaktuara në ligje e akte nënligjore në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

"**Tarifa e Koncesionit**" përbëhet nga tarifa që i paguhen/janë paguar nga Koncesionari Autoritetit Kontraktues dhe enteve në varësi, siç përkufizohet, përcaktohet dhe rregullohet nenin 12.

"**Faza e Implementimit**" nënkupton periudhën kohore nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate e deri në fillimin e ofrimit të shërbimeve.

"**Garanci Kontrate**" është Sigurimi e Kontratës siç përcaktohet në dokumentet standarde të procedurës konkurruese, i cili shërben për të garantuar Autoritetin Kontraktues lidhur me përmbushjen në kohë të detyrimeve të Koncesionarit sipas kësaj kontrate.

"**Autoritet Kontraktues**" është Bashkia Vlorë, ose çdo organ tjetër suksesues i saj.

"**Koncesionari**" është bashkimi i përkohshëm i shoqërive i themeluar me kontratën datë 04.01.2015, i përbërë nga shoqëritë TIS Holding LLC (kryesuese) dhe On Track Innovations LTD.

"**Përfaqësues i Autoritetit Kontraktues**" nënkupton çdo përfaqësues që Autoriteti Kontraktues mund të caktojë herë pas here për ta përfaqësuar atë në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate, me kusht që, Autoriteti Kontraktues të njoftojë menjëherë Koncesionarin për çdo ndryshim ose zëvendësim të tij.



"**Akte korruptive**" nënkuptojnë aktin e premtimit, dhënies, marrjes ose rënies dakord për të marrë para ose ndonjë objekt tjetër me vlerë, me synim korruptiv ose synim për të ushtruar ndikim mbi një nëpunës publik në përmbushjen e detyrave të tij zyrtare dhe që shkaktojnë përgjegjësi penale në përputhje me parashikimet e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

"**Ngjarje e Forcës Madhore**" ka kuptimin e përcaktuar në nenin 24.

"**Praktikë e Industrisë së Mirë**" nënkupton praktikat, metodat, standardet, procedurat dhe rekomandimet në pajtim me ligjet përgjithësisht të ndjekura në lidhje me zhvillimin e projektit, që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga një kontraktor, inxhinier ose operator i aftë dhe me përvojë, sipas rastit, nën të njëjtat rrethana ose në rrethana të ngjashme, praktikat, metodat, standardet dhe procedurat e të cilave do të përfshijnë pa kufizim Standardet dhe Normat e Zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

"**Pasojë e Rëndë Materiale**" nënkupton çdo pasojë të rëndë materiale mbi (i) aftësinë e Kompanisë Konkensionare për të ushtruar dhe përmbushur çdo të drejtë dhe detyrim sipas Kontratës nën rrethana normale dhe/ose (ii) ligjshmërinë, vlefshmërinë, natyrën detyruese ose zbatueshmërinë e Kontratës.

"**Veprimi Qeveritar i Pafavorshëm Material**" ka kuptimin e përcaktuar në nenin 25.

"**Shoqëri Konkensionare**" është shoqëria tregtare e cila krijohet me qëllim implementimin e projektit konkensionar, e krijuar në përputhje me ligjet që rregullojnë themelimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohet në vijim në Kontratë.

"**Ngjarje e Zgjatur e Forcës Madhore**" nënkupton një Ngjarje të Forcës Madhore që (i) zgjat më shumë se njëqind e njëzet (120) ditë të njëpasnjëshme nga data kur ka ndodhur ose (ii) në lidhje me të cilën është e qartë, që në datën e ndodhjes, se do të zgjasë më shumë se njëqind e njëzet (120) ditë të njëpasnjëshme.



"Gëzimi i qetë" nënkupton të drejtën ekskluzive të Koncensionarit për të përdorur dhe gëzuar, Zonën e Projektit, pa ndërhyrje të panevojshme nga Autoriteti Kontraktues ose ndonjë organ tjetër administrativ shtetëror, qendror ose lokal.

"Afati" nënkupton 15 (pesëmbëdhjetë) vjet ose 180 (njëqind e tetëdhjetë) muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi, për sa kohë që kjo Kontrate nuk do të mbarojë më parë, ose shtyhet, në përputhje me parashikimet e saj.

NENI 2

Interpretimi

Për sa kohë që konteksti i kësaj Kontrate nuk e kërkon ndryshe:

- (i) Fjalët e çdo gjinie përfshijnë gjininë e njëra tjetrës;
- (ii) Pjesa Hyrëse dhe Anekset, Dokumentet dhe Shtojcat e kësaj Kontrate do të formojnë pjesë përbërëse të saj dhe të pandashme të saj.
- (iii) Referencat ndaj çdo miratimi përfshijnë çdo amendim ose ri-miratim të atij miratimi dhe çdo rregull ose rregullore, të bërë sipas atij miratimi;
- (iv) Referencat të "kjo Kontratë" ose "kjo Kontratë Koncesioni" ose çdo marrëveshje ose dokumenti tjetër do të interpretohen si referencë ndaj një marrëveshjeje ose dokumenti të tillë siç amendohen, modifikohen ose plotësohen dhe në fuqi herë pas here dhe do të përfshijnë një referencë ndaj çdo dokumenti që amendon, modifikon ose plotëson atë ose lidhet, bëhet ose jepet sipas ose në përputhje me kushtet e saj;
- (v) Kurdoherë që kjo Kontrate i referohet një numri "ditësh", ky numër do t'i referohet ditëve kalendarike, nëse Ditët e Punës nuk specifikohen;
- (vi) Çdo referencë ndaj një "muaji" ose "viti" do të interpretohet si referencë ndaj një muaji ose viti kalendarik;
- (vii) Çdo fjalë, term, frazë dhe shkurtime me germa kapitale, përdorur specifikisht në ndonjë Aneks, Shtojcë ose Lidhje ose ndonjë Aneks ose Shtojcë do të kenë kuptimet e përcaktuara në atë Shtojcë ose Bashkëlidhje, sipas rastit;



-
- (viii) Në rast të ndonjë mos-pajtueshmërie midis ndonjë fjale me gërma kapitale, termi të përkufizuar, fraze ose shkurtimi të përcaktuar në Nenin I dhe çdo dispozite, fjale, termi, fraze ose shkurtimi me gërma kapitale të përcaktuar në ndonjë Aneks, Shtojcë ose Bashkëlidhje, kuptimi i përcaktuar në atë Aneks, Shtojcë ose Bashkëlidhje do të ketë përparësi mbi kuptimin e përcaktuar në Nenin 1, për sa kohë që konteksti i kësaj Kontrate nuk e kërkon ndryshe;
- (ix) Në rast të një konflikti ndërmjet neneve dhe Anekseve ose Shtojcave, Palët do të përpiqen të zgjidhin konfliktin në radhë të parë, duke e lexuar këtë Kontratë në tërësi dhe dispozita që është më specifike do të ketë përparësi. Nëse konflikti vazhdon të ekzistojë pavarësisht përpjekjeve të Palëve për ta zgjidhur atë siç parashikohet në fjalinë paraardhëse, dispozitat e Anekseve ose Shtojcave do të kenë përparësi ndaj parashikimeve të kontratës, në këtë kuptim, për të shmangur çdo paqartësi do të konsiderohet se në rast konflikti, dispozitat e dokumenteve standarde të procedurës konkurruese si dhe oferta e koncensionarit, përfshirë shtojcat dhe vizatimet do të kenë përparësi mbi dispozitat e kësaj kontrate,; dhe
- (x) Titujt e neneve, kapitujve në këtë Kontrate vendosen për lehtësi dhe vetëm për qëllime reference dhe nuk ndikojnë në ndonjë mënyrë interpretimin e kësaj Kontrate.
- (xi) Në qoftë se ndonjë ose më shumë dispozita të kësaj marrëveshjeje, janë ose bëhen të pavlefshme, kjo pavlefshmëri, e tashme ose e ardhshme, nuk do të passjellë automatikisht pavlefshmërinë e të gjithë kontratës. Palët do të zëvendësojnë parashikimet e pavlefshme, me të tjera parashikime të vlefshme të cilat i afrohen qëllimit të palëve e rregullimit të mëparshëm.

NENI 3

Informacioni Konfidencial

Koncensionari dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

Koncensionari mund t'i japë nënkontraktorit të tij dokumente të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nënkontraktorin që të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Koncensionari duhet të përfshijë në kontratën



e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin më sipër.

NENI 4

Prona Intelektuale

Palët bien dakord dhe pranojnë se pronësia intelektuale mbi aplikimet telematike, modelin e biznesit, logo, dizajni etj. janë në shërbim të zbatimit të kësaj kontrate, por në asnjë rast nuk kalon pronësia e të drejta të tilla, nga Konkensionari tek Autoriteti Kontraktues. Sa më sipër përbën një parashikim të ndryshëm nga neni 6 i Kushteve të Përgjithshme të Kontratës në Dokumentet Standarte të Procedurës Konkurruese,

Koncensionari, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specififikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Konkensionari gjatë zbatimit të kontratës. Konkensionari mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

Koncensionari duhet të garantojë Autoritetin Kontraktues për zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, Konkensionari duhet t'i japë Autoritetit Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Konkensionarit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.



TË DREJTAT E KONCESIONIT

NENI 5

Dhënia e të Drejtave të Koncesionit/të drejtat e Konkensionarit

Nga data e nënshkrimit, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit, i cili pranon, të drejtat ekskluzive gjatë gjithë Afatit për të sistemuar, administruar e menaxhuar parkimin në qytetin e Vlorës, në shtrirjen territoriale dhe sipas metodikës së përshkruar në ofertën e Konkensionarit dhe Dokumentet Standarte të Procedurës Konkurruese.

NENI 6

Dhënia e Zonës së Projektit

Pa cënuar në asnjë mënyrë Nenin 3 të mësipërm, e Drejta e Kalimit, Gëzimi i Qetë dhe e drejta e kryerjes së punimeve për vendosjen e infrastrukturës telematike dhe sinjalistikës horizontale dhe vertikale do të konsiderohet se i jepet Koncesionarit për qëllimet e implementimit të kësaj kontrate. Pëlqimi i autoritetit kontraktues do të konsiderohet i dhënë me nënshkrimin e kësaj kontrate, për të gjithë zonën e projektit, pa pasur nevojë Konkensionari/shoqëria koncensionare, të kërkojë, aplikojë apo paraqesë ndonjë leje apo certifikatë shtesë.

Autoriteti Kontraktues angazhohet të asistojë Konkensionarin në çdo rast ai përballlet me palë të treta që pengojnë implementimin e projektit në cilëndo fazë të tij, përfshirë edhe procesin e instalimit e mirëmbajtjes së infrastrukturës telematike dhe sinjalistikës horizontale dhe vertikale, asistencë e cila jepet në çdo formë të përshtatshme, përfshirë ndër të tjera edhe angazhimin e strukturave të Policisë Bashkiake në rast se është e nevojshme për zbatimin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues garanton gjithashtu dhe do të ofrojë të gjithë asistencën e nevojshme për lidhjen e projektit me rrjetin infrastrukturor ekzistues, pa qenë i detyruar Konkensionari të kryejë më shumë se sa ka paraqitur në ofertën e tij ekonomike dhe teknike.



Pa rënë ndesh me kuadrin ligjor në fuqi, Autoriteti Kontraktues dhe Konkensionari angazhohen të konsiderojnë zgjerimin e zonës së projektit duke negociuar termat përkatës, në rast të performancës së kënaqshme të konkensionarit dhe interesit reciprok.

Në datën e hyrjes në fuqi, zona e projektit dhe oraret e ditët e aplikueshme jepen në tabelën vijuese:

TABELE PERMBLEDHESE E RRUGEVE TE PARKIMIT

Nr.	Emertimi i Rrugeve	NJE KRAH - DY KRAHE		Orari i Parkimit	DITET E PARKIMIT	PARKIMI DITEN E SHITUNE
1	RAKIP MALILE	-	PO	8 - 16	HENE-PREMTE	8-14
2	JANAQ KILICA	-	PO	8 - 16	HENE-PREMTE	8-14
3	DEMOKRACIA	-	PO	8 - 16	HENE-PREMTE	8-14
4	ANITA BITRI	-	PO	8 - 16	HENE-PREMTE	
5	HYSNI ALIMERKO	PO	-	8 - 16	HENE-PREMTE	
6	RIZA SALATI	-	PO	8 - 16	HENE-PREMTE	
7	HASAN KUSHTA	-	PO	8 - 20	HENE-PREMTE	8-14
8	BULEVARDI ISMAIL QEMALI	-	PO	8 - 20	HENE-PREMTE	8-14
9	SEGMENTI PARA HOTEL "GRETA"	-	PO	8 - 16	HENE-PREMTE	8-14
10	GJERGJ ARANITI	-	PO	8 - 18	HENE-PREMTE	
11	KOSOVA (DY SEGMENTET NE DY KRAHE)	-	PO	8 - 20	HENE-PREMTE	8-14
12	TRANSBALLKANIKE	-	PO	8 - 20	HENE-PREMTE	8-14
13	MURAT TERBACI (6 muaj)	-	PO	8 - 20	HENE-PREMTE	8-14
14	KASTRIOT GJINI	PO	-	8 - 14	HENE-PREMTE	
15	LEF SALLATA	PO	-	8 - 16	HENE-PREMTE	
16	HAJREDIN HAXHIRAJ	PO	-	8 - 14	HENE-PREMTE	
17	VELEDIN KOLLOZI	PO	-	8 - 20	HENE-PREMTE	
18	MISTO MELE	PO	-	8 - 16	HENE-PREMTE	
19	TASIM JONUZI	PO	-	8 - 16	HENE-PREMTE	
20	SULEJMAN DELVINA	PO	-	8 - 16	HENE-PREMTE	
21	PARA "PLAZA E SHQIPER	PO	-	8 - 20	HENE-PREMTE	8-14



22	SEGMENTI Murat Terbacì - TEK RRAPI (6 muaj)	PO	-	8 - 20	HENE- PREMTE	8-14
23	SHESHI TEK KRISTALI (UJI I FTOHTE) - TEK HOTEL "NEË YORK" (6 muaj)	PO	-	8 - 20	HENE- PREMTE	8-14
24	PERLAT REXHEPI	PO	-	8 - 16	HENE- PREMTE	
25	PARA POSTES	PO	-	8 - 16	HENE- PREMTE	8-14

NENI 7

Nënkontraktimi

Konkensionari ka të drejtë të nënkontrakttojë punët dhe shërbimet objekt i kontratës. Për nënkontraktimin zbatohen parashikimet e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, si dhe dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik në përputhje me rrethanat faktike.

MARRËVESHJET

NENI 8

Shoqëria Konkensionare

Konkensionari ka detyrimin që:

Të krijojë brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e Kontratës së Konkensionit, shoqërinë konkensionare, që do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.

Me krijimin e shoqërisë së konkensionare, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me këtë kontratë do të transferohen nga Konkensionari tek Shoqëria Konkensionare duke filluar që nga data e regjistrimit të Shoqërisë Konkensionare në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.



Koncesionari dhe shoqëria e re e krijuar do të jenë solidarisht dhe veçmas përgjegjës për të gjitha te drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë kontratë.

Forma e shoqërisë së re koncensionare do të jete “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “shoqëri aksionare”, duke funksionuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”.

Objekti i shoqërisë së re koncensionare do të jetë ngushtësisht zhvillimi, operimi, i projektit koncensionar, duke përfshirë këtu dhe kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, përfshirë importin e pajisjeve, projektimin, kryerjen e punimeve të ndryshme, në funksion të realizimit të projektit koncensionar. Shoqëria e re koncensionare do të ushtroje aktivitetin e saj në përputhje me Periudhën e Koncesionit të kësaj Kontrate.

Shoqëria e re do të themelohet vetëm nga Koncesionari.

NENI 9

Detyrimet e fazës së para-implementimit nën përgjegjësinë e koncesionarit

Brenda një periudhe prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga “Data e Hyrjes në fuqi” Koncesionari do të sigurojë dorëzimin ndaj Autoritetit Kontraktues, të:

- (i) Kopjeve të vërtetuara të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Çertifikatës së Regjistrimit Tregtar të Shoqërisë Koncensionare;

NENI 10

Fillimi i Fazës së Implementimit

Fillimi i Fazës së Implementimit konsiderohet të ndodhë kur të jetë përmbushur detyrimi i parashikuar në nenet 8 dhe 9 (ose hequr dorë nga Autoriteti Kontraktues në masën e lejuar me ligj).



NENI 11

Efekt i Mbarimit mbi Garancinë e Kontratës

Në rast të shkeljes materiale nga një Palë të kushteve të saja të parashikuar në nenet e kësaj Kontrate, shkelje e cila nuk justifikohet nga një Ngjarje e Qenies në Vonesë nga Autoriteti Kontraktues, një Veprim Qeveritar i Pafavorshëm Material (në rastin e shkeljes së Koncesionarit), një ngjarje e Forcës Madhore ose një rast tjetër parashikuar ndryshe me Ligj, Pala që nuk ka bërë shkeljen ka të drejtë t'i bëjë Palës tjetër Njoftimin e Mbarimit.

Në rastin kur mbarimi rezulton nga një shkelje e Koncesionarit, sipas parashikimit të mësipërm, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të ekzekutojë Sigurimin e Kontratës.

NENI 12

Tarifa e koncesionit

Koncesionari duhet t'i paguaje Autoritetit Kontraktues një tarifë koncensionare në masën e ALL 10 000 000 (dhjetë milionë lekë) në vit për 2 (dy) vitet e para dhe 10 000 000 (dhjetë milionë lekë) në vit plus 2% (dy përqind) të xhiros vjetore për çdo vit në vazhdim.

Tarifa e Koncesionit nga Koncesionari për Autoritetin Kontraktues bëhet e kërkueshme me bazë vjetore, brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorezimit të bilancit të Shoqërisë Koncensionare pranë Autoriteve Tatimore.

Tarifa koncensionare i paguhet Autoritetit Kontraktues brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e faturës, nga Autoriteti Kontraktues Koncesionarit. Për çdo dite vonese të pagesës së tarifës koncensionare paguhet kamatë vonese sipas ligjit.



NENI 13

Ndryshimi i tarifave të aplikueshme nga koncensionari

Palët bien dakord dhe pranojnë të rinegociojnë dhe amendojnë tarifat e aplikueshme për qytetarët nga koncensionari, çdo dy vjet, bazuar në normën e inflacionit, siç përcaktohet nga Banka e Shqipërisë, për rritjen e pësuar në periudhën deri në datën e negocimit, kushtet e tregut, potencialet zhvillimore etj. Në çdo rast tarifa përkatëse nuk mund të jetë më e vogël se tarifa fillestare e propozuar plus shtesën për shkak të inflacionit.

Tarifat përfshijnë tarifat për shërbimin e zakonshëm, si dhe tarifa shtesë që mund të aplikohen në formën e penaliteteve për përdorues të ndryshëm të shërbimit që shkelin rregullat e zbatueshme në planin kohor dhe material. Në lidhje me këto penalitete Koncensionari aplikon tarifën e përcaktuara kohë mbas kohë me Vendime të Këshillit Bashkiak të Autoritetit Kontraktues. Në çdo rast penalitetet dhe cdo tarifë tjetër e aplikueshme nuk mund të jetë më e vogël se tarifa aktuale në fuqi plus rritjen për shkak të inflacionit. Në rast konflikti zbatohet tarifa më e lartë.

Negocimi i tarifave sipas këtij neni do të realizohet si rregull tremujorin e parë të çdo viti të dytë të kontratës dhe/ose brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga njoftimi i drejtuar palës tjetër për këtë qëllim. Në rast mungese të marrëveshjes për këtë qëllim, çështja i kalon autoritetit të përcaktuar në kontratë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

KONTROLLI – INVESTIMET MINIMALE TË AKSIONEVE TË ZAKONSHME

NENI 14

Kontrolli

Deri në përfundim të Afatit, Koncensionari Kontrollon Shoqërinë Koncensionare, me kusht që

(i) çdo pjesëmarrës në kapitalin e shoqërisë (duke përfshirë pjesëmarrësin Kryesor) të ketë të drejtë të transferimit të pjesët e tij lirish në një pjesëmarrës tjetër (ortak/aksionar) në çdo kohë gjatë Afatit nëse ky transferim nuk rezulton në transferimin e Kontrollit nga Pjesëmarrësi Kryesor dhe

(ii) çdo transferim tjetër (duke përfshirë një transferim të Kontrollit) i nënshtrohet aprovimit



paraparak të Autoritetit Kontraktues, që nuk mbahet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme; po ashtu me kusht që në lidhje me çdo transferim të propozuar në palë të treta (duke përfshirë transferimin e Kontrollit), Autoriteti Kontraktues i kushton rëndësinë e duhur eksperiencës, gjendjes financiare (që përfshin mbështetjen me kredi nga palët e treta), qëndrueshmërinë dhe reputacionin e ortakut/aksionerit përfitues.

NENI 15

Shoqëria e Projektit – Marrëveshjet e Koncesionarit

Shoqëria Koncesionare, pa pëlqimin paraparak të Autoritetit Kontraktues nuk do të përfshihet në ndonjë biznes tjetër të ndryshëm nga Projekti. Megjithatë kjo nuk do të thotë se shoqëria koncesionare do të kërkojë këtë pëlqim për veprimtari të ndryshme aksesore e të lidhura me zbatimin e projektit. Kusht i nevojshëm për dhënien e pëlqimit nga Autoriteti Kontraktues është paraqitja e informacionit të plotë dhe metodologjisë së përshtatshme për ndarjen e të ardhurave nga aktivitete të ndryshme me qëllim arkëtimin e saktë të tarifës koncesionare.

Shoqëria koncesionare mund të shtrijë aktivitetin në të ardhmen në zona të tjera të Bashkisë Vlorë apo Njësi të tjera Vendore, duke amenduar këtë kontratë dhe në rastin e Njësive të Tjera Vendore, vetë apo nëpërmjet shoqërive të posaçme, duke aplikuar metodologji të përshtatshme për ndarjen e të ardhurave nga aktivitete të ndryshme me qëllim arkëtimin e saktë të tarifës koncesionare.

Me themelimin e njoftimin e Autoritetit Kontraktues, shoqëria e re koncesionare konsiderohet se zëvendëson koncesionarin, duke qenë ky i fundit solidarisht përgjegjës, në lidhje me të gjitha të drejtat dhe detyrimet objekt i kësaj kontrate.



NENI 16

Autorizimet dhe monitorimi

Nëse është rasti Koncesionari do të marrë, ruajë dhe shqyrtojë gjithmonë të gjitha Autorizimet e kërkuara ose të dobishme për Projektin (me shpenzimet e veta por me asistencën e arsyeshme të Autoritetit Kontraktues, kur kërkohet), sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë dhe Koncesionari do të japë pa vonesë e në çdo kohë informacionin që mund ti kërkohet nga Autoriteti Kontraktues mbi implementimin e projektit. Për qëllime të monitorimit, përfaqësues të Autoritetit Kontraktues do të kenë të drejtë të kontrollojnë zbatimin e inspektojnë në vend ofrimit e shërbimit nga Koncesionari, gjithmonë duke ju referuar termave të kontratës dhe ofertës së koncesionarit. Raportimet mbi monitorimet i vihen në dispozicion për vërejtje Koncesionarit dhe nëse është rasti i përcillen autoritetit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

NENI 17

Projekti dhe Implementimi

Me koston dhe shpenzimet e veta, Koncesionari do të përmbushë projektimin dhe implementimin në përputhje me fazat e përcaktuara në ofertë, të cilat në mënyrë të përmbledhur jepen bashkëngjitur kësaj kontrate, si koha e implementimit të sistemit.

NENI 18

Përgjegjësia e Koncesionarit

Koncesionari do të jetë ekskluzivisht përgjegjës për çdo mangësi në projekt. Pamundësia e Autoritetit Kontraktues për të kundërshtuar ndonjë projekt, skicim projekti ose specifikim apo ndryshim ndaj tij nuk do të interpretohet si heqje dorë nga Autoriteti Kontraktues të ndonjë prej të drejtave të tij sipas kësaj Kontrate ose në ndonjë mënyrë ta lehtësojë Koncesionarin nga



detyrimet e tij. Në vijim sa më sipër, Koncesionari do të jetë ekskluzivisht përgjegjës për fizibilitetin teknik, kapacitetin operacional dhe besueshmërinë e projektit dhe çdo komponenti të tij, me kushtin që çdo mangësi e vërejtur të jetë rrjedhojë e përgjegjësi e Koncesionarit e pandikuar nga veprime të të tretëve.

Në mënyrë të veçantë Koncesionari angazhohet të zbatojë normat në fuqi të sigurisë rrugore, si dhe aplikojë standarde të atilla që të garantojnë aksesin në shërbime të personave me aftësi të kufizuara.

NENI 19

Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

Autoriteti Kontraktues mund t'i kërkojë Autoriteti Kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Koncesionari ka kryer veprime të korruptuara. Veprimet e korruptuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Koncesionari nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtëkoncesion/partneritet publik privat.

Koncesionari duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë mbajtjen e llogarive dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

NENI 20

Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

Autoriteti Kontraktues mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Koncesionari falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi Koncesionarit njoftim me shkrim për ndërprerjen.



NENI 21

Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

Autoriteti Kontraktues mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik. Kjo ndërprerje do të konsiderohet pavarësisht interesit publik si një veprim qeveritar i pafavorshëm material dhe do të dëmshpërblehet në përputhje me parashikimet e kësaj kontrate.

Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi Koncesionarit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Përveçse sa parashikohet tjetër në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues duhet të paguajë Koncesionarin edhe për të gjitha investimet e kryera përpara ndërprerjes, si dhe duhet t'i paguajë Koncesionarit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të investimeve, të cilat mund të vijnë si rrjedhojë e kontratave me palë të treta. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Koncesionari do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

NENI 22

Programi i implementimit dhe shtyrjet

Nëse një pengesë jashtë kontrollit të Koncesionarit ka të ngjarë të çonte në një vonesë në realizimin e projektit ose në arritjen e ndonjë prej Periudhave të Rëndësishme, Koncesionari duhet t'i dërgojë një raport Autoritetit Kontraktues brenda tridhjetë (30) ditësh pune në lidhje me zbulimin e pengesës, duke parashtruar arsyet që çuan ose do të çojnë në një vonesë të tillë, dhe masat që do të ndiqen për të shmangur ose minimizuar vonesën në përfundimin e Punimeve nga Data e Planifikuar e Përfundimit. Autoriteti Kontraktues mbi bazën e këtij raporti autorizon me shkrim shtyrjen e cila duhet të arsyetohet në lidhje me shkaqet që e kanë shkaktuar atë. Autoriteti Kontraktues duhet të asistojë Koncesionarin për të shmangur gjithçka pengon zbatimin e projektit/Kontrattës.



NENI 23

Rrethanat specifike gjatë implementimit të projektit: Shtyrjet

Çdo fazë e projektit mund të shtyhet me ndodhjen e:

- (i) Një Ngjarjeje të Forcës Madhore;;
- (ii) Një Ngjarjeje të Qenies në Vonesë të Autoritetit Kontraktues;
- (iii) Zbulimit të relikeve kulturore arkeologjike, fosileve, pargjeve të dheut për varrime dhe vendeve përkujtimore, mbetjeve artistike historike dhe çdo seksioni tjetër me rëndësi arkeologjike, gjeologjike dhe historike mbi zonën e projektit, që rezulton në punime publike të cilat ndërhyjnë në ndërtimin e përfundimit të Punimeve nga Koncesionari, me kusht që shtyrja të jetë në përpjesëtim me kohëzgjatjen e ngjarjes përkatëse (dhe Palët do të kenë të drejtë t'ia referojnë çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Nen mekanizmit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve), ose
- (iv) Çdo njarje tjetër, e tillë si Veprimi i Pafavorshëm Material Qeveritar dhe ose ndonjë veprim/rast tjetër që konsiderohet e tillë e caktohet shtyrja përkatëse nga autoriteti i caktuar për zgjidhjen e konfliktit midis palëve.

Shtyrjet do të konsiderohen edhe shtyrjet që lidhen me pengesat që lindin vetëm në një zonë të projektit, të tilla si, por pa u kufizuar në, punime publike në rrugë të caktuara, kohëzgjatja e të cilave do të pengojë Konkensionarin të ushtrojë të drejtat e tij. Të ardhurat e munguara të realizuara nga Konkensionari në këtë rast, duke u bazuar në periudhën parardhëse më të afërt (periudhës përpara shtyrjes dhe të gjatë në kohë sa shtyrja) dhe në mungesë të këtij informacioni, planit të biznesit do t'i zbriten tarifës konkensionare të periudhës vijuese/periudhave vijuese.

Në rast se ndodhin ngjarjet e lartpërmendura, do të ketë një shtyrje dhe nëse është rasti, Konkensionari do të kërkojë dhe një kompensim financiar proporcional duke ju referuar planit të biznesit lidhur me pritshmërinë e të ardhurave. Në lidhje me këtë, Konkensionari mund të zgjedhë të reduktojë tarifën konkensionare në të njëjtën masë me shumën për t'u kompensuar për periudhën/periudhat vijuese.



Parashikimet e këtij nenin nuk zbatohen për ndërprerje të shkurtra (më pak se 24 orë) që vijnë si pasojë e aktiviteteve me karakter social, kulturor dhe politik. Autoriteti Kontraktues angazhohet të njoftojë paraprakisht Konkensionarin mbi aktivitetet e ndryshme që ndikojnë në zbatimin e projektit.

FORCA MADHORE DHE VEPRIMI MATERIAL I RËNDË QEVERTAR

NENI 24

Forca Madhore

"Ngjarje e Forcës Madhore" nënkupton çdo rrethanë që nuk është brenda kontrollit të arsyeshëm, direkt ose indirekt të Palës së Cënuar ("**Pala e Cënuar**") që çon ose shkakton një dështim total ose të pjesshëm të Palës së Cënuar, në plotësimin e ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate (përveç pagesës së parave), por vetëm nëse dhe në shkallën që:

- (i) Kjo rrethanë, pavarësisht nga ushtrimi i kujdesit të arsyeshëm, nuk mund ose nuk mund të jetë parandaluar, shmangur ose eliminuar nga Pala e Cënuar;
- (ii) Pala e Cënuar ndërmoi ose ka ndërmarrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, kujdesin e duhur dhe masat alternative të arsyeshme, me qëllim që të shmangë ndikimin e kësaj ngjarjeje mbi aftësinë e Palës së Cënuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate dhe për të lehtësuar pasojat rrjedhëse;
- (iii) Ngjarja nuk është ose nuk ishte, rezultat direkt ose indirekt i shkeljes nga Pala e Cënuar të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate; dhe
- (iv) Pala e Cënuar e ka njoftuar Palën tjetër ("**Palën e Pacënuar**").

Ngjarjet e Forcës Madhore përfshijnë rrethanat e mëposhtme, me kusht që ato të plotësojnë kriteret e përcaktuara në përkufizimin e Ngjarjes së Forcës Madhore si më lart:

- (i) Akte të luftës, pushtimit ose akt të armikut të huaj ose akte terrorizmi, bllokade, embargoje, që në çdo rast ndodhin brenda ose që përfshijnë Republikën e Shqipërisë;
- (ii) Akte rebelimi, trazire, sulme civile, greva të natyrës politike, akt ose fushatë terrorizmi ose sabotazhi të një natyre politike që në çdo rast ndodhin brenda Republikës së Shqipërisë;
- (iii) rrufe, zjarre, tërmet, stuji, ciklon, tajfun, uragan ose fatkeqësi tjetër natyrore;



(iv) veprimet e Autoritetit Kontraktues, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual

Pala e Prekur do të çlirohet nga përbushja dhe nuk do të interpretohet të jetë në vonesë në lidhje me përbushjen e Kontratës, për sa kohë që dhe deri në shkallën që ky dështim për përbushje ka ndodhur për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore.

Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Koncensionari duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep udhëzime të ndryshme, Koncensionari duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore. Koncensionari nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.


NENI 25

Veprimi Qeveritar i Pafavorshëm Material

"Veprimi Qeveritar i Pafavorshëm Material" do të nënkuptojë çdo veprim ose mosveprim, pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues, autoritete suksesues të tij ose një Ent tjetër Qeveritar, ose palë të treta të çdo lloji që veprojnë në përputhje me udhëzimet e Autoritetit Kontraktues, suksesuesit të Autoritetit Kontraktues dhe/ose një Enti Qeveritar, përfshirë këtu dhe autoritetet gjyqësore dhe prokurorinë e Republikës së Shqipërisë, që ka/sjell një Pasojë të Rëndë Materiale.

Veprimi Qeveritar i Pafavorshëm Material do të nënkuptojë rrethanat e mëposhtme (nëse ato kanë një Efekt të Pafavorshëm Material):

- (i) Mosdhënia ose vonesa e paarsyeshme për të dhënë Autorizime (duke përfshirë Liçencat) të nevojshme për Koncensionarin për qëllime të përbushjes së duhur nga Koncensionari të detyrimeve të tij dhe zbatimi i të drejtave të tij sipas kësaj



-
- Marrëveshjeje, megjithatë, me kusht që Koncesionari të ketë plotësuar të gjitha detyrimet e tij;
- (ii) Shpronësimi, kërkitimi, konfiskimi ose shtetëzimi i të drejtave të Koncesionit qoftë edhe në rastin e interesit publik;
 - (iii) Ndalimi ose kufizimi mbi riatdhësimin ose transferimin e përfitimeve ose fitimeve të Koncesionarit dhe shërbimit të huasë nga Republika e Shqipërisë (duke përfshirë ndalimin dhe kufizimet e shkëmbimit valutor).

Pavarësisht ndonjë elementi në kundërshtim me këtë dokument, një ndryshim i ligjit nuk do të konsiderohet të përbjë një Qeveritar i Pafavorshëm Material dhe nuk do të shkaktojë kompensimin sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse nuk synon drejtpërdrejt Projektin dhe/ose nuk është diskriminues kundër Koncesionarit. Megjithatë, ndryshime në legjislacion që ndalojnë dhe/ose ndryshojnë thelbësisht kushtet e zhvillimit të aktivitetit dhe/ose ndonjë nga zërat e tij, duke përfshirë këtu edhe importin e eksportin e çdo lënde të parë/pajisjeje të nevojshme për këtë qëllim, do të konsiderohen veprim qeveritar i pafavorshëm material për qëllimet e këtij neni.

Brenda tridhjetë 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi drejtuar Autoritetit Kontraktues mbi një Veprim Qeveritar të Pafavorshëm Material, Autoriteti Kontraktues do të sigurojë kompensimin dhe/ose zhbërjen e veprimit në fjalë. Tej këtij afati përveç kompensimit përkatës Autoriteti Kontraktues detyrohet dhe për pagimin e kamatës ligjore në përputhje me ligjin në fuqi.

Nëse Autoriteti Kontraktues dështon të sigurojë kompensimin dhe/ose zhbërjen e veprimit qeveritar të pafavorshëm material, para skadimit të periudhës prej 30 (tridhjetë) ditësh, Palët do ta diskutojnë menjëherë, me qëllim që të arrijnë një zgjidhje reciproke të kënaqshme për të rikuperuar Koncesionarin në pozicionin që do të kishte qenë nëse ky Veprim i Rëndë Qeveritar Material nuk do kishte ndodhur (duke përfshirë kompensimin për kostot dhe humbjen e përfitimeve) dhe ose zëvendësimet përkatëse në zonën e projektit. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk ndreq ose rikuperon brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga fillimi i këtij konsultimi (ose nëse Autoriteti Kontraktues nuk diskuton ose ka refuzuar të diskutojë), Koncesionari do të ketë të drejtë të prishë këtë Marrëveshje duke qenë i detyruar Autoriteti Kontraktues të shpërblejë çdo



dëm të shkaktuar koncesionarit duke përfshirë këtu, por pa u kufizuar në shpenzimet e ndërtimit, mirëmbajtjes, projektimit, fitimin e munguar etj.

Autoritetit Kontraktues do të jetë i vetmi përgjegjës përballë palëve të treta që mund të kenë ndonjë pretendim lidhur me marrëveshjen, kontrata dhe akte të tjera të ngjashme të lidhura me koncesionarin në lidhje me Projektin, të tilla si por pa u kufizuar në kontrata qiraje me persona të tretë, qiraje financiare, kontrata kredie bankare, pretendime të pronësisë së tokës ku shtrihet projektim ndotje të mjedisit përfshirë dhe ajo akustike, e drejta e aksesit, servitute të ndryshme etj. Në rast të vendimeve gjyqësore/administrative të formës së prerë të cilat legjitimojnë të tretët në kërkimet e tyre, çdo dëm i pësuar nga Koncesionari do të mbulohet nga Autoriteti Kontraktues, ndërsa Koncesionari ka të drejtë të zbresë këtë shumë nga pagasa e periudhës/periudhave vijuese.

MBARIMI I MARRËVESHJES

NENI 26

Ngjarje të Qenies në Vonesë nga ana e Koncesionarit

Sa më poshtë do të përbëjë një "Ngjarje të Qenies në Vonesë nga ana e Koncesionarit":

- i) Mospajtimi i Koncesionarit me ndonjë aspekt material me kërkesat e projektit (përveç vonesave për të cilat dëmet e shlyera janë të maturuara në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate);
- ii) Një ndërprerje operimi nga ana e Koncesionarit e Punimeve, për më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë ose në më shumë se 25% (njëzet e pesë) përqind të zonës së projektit ose një kombinim i të dyjave që afekton në më shumë se 25% (njëzet e pesë) përqind tarifën e koncesionit.
- iii) Mospagesa nga Koncesionari i detyrimeve brenda periudhave kohore të specifikuara ose një dështim i Koncesionarit për të bërë ndonjë pagesë tjetër të maturuara dhe të pagueshme sipas kësaj Kontrate);
- iv) Koncesionari është denuar për ndonjë Veprim Korruptiv me vendim gjyqësor të formës së prerë



-
- v) çdo shkelje e rëndë materiale e kësaj Kontrate, e caktuar si e tillë më poshtë shprehimisht ose në rast të kundërt e shpallur si e tillë nga autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas kësaj kontrate.

NENI 27

Ngjarje e Qenies në Vonesë e Autoritetit Kontraktues

Sa më poshtë do të përbëjë një "Ngjarje të Qenies në Vonesë të Autoritetit Kontraktues":

- (a) Çdo shkelje materiale e kësaj Marrëveshjeje, e caktuar si e tillë më poshtë shprehimisht ose jo; ose
- (b) Ndodh një Veprim Qeveritar i Pafavorshëm Material dhe nuk ndreqet ose rregullohet në përputhje me nenin 25 më lart.

NENI 28

Procedura e Mbarimit

Autoriteti Kontraktues mund ta prishë këtë Kontratë duke i bërë Koncesionarit një Njoftim Mbarimi vetëm bazuar në një Ngjarje të Qenies në Vonesë nga ana e Koncesionarit dhe vetëm pasi kjo pasojat e ngjarjes nuk janë ndrequr brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi ndaj Koncesionarit.

Koncesionari mund ta prishë këtë Marrëveshjeje duke bërë një Njoftim Mbarimi drejtuar Autoritetit Kontraktues, bazuar në:

- (a) Një Ngjarje të Qenies në vonesë nga ana e Autoritetit Kontraktues që nuk është ndrequr brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i saj ndaj Autoritetit Kontraktues;
- (b) Një Veprimi Qeveritar i Pafavorshëm Material jo i ndrequr ose i mbetur parregulluar, siç parashikohet në nenin 25 më lart.



NENI 29

Pagesat e Mbarimit të Marrëveshjes

Në rast të mbarimit të kësaj Marrëveshjeje, Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit kompensim për të gjithë periudhën e mbetur të koncesionit referuar të ardhurave sipas plan biznesit plus një penalitet minimalisht në masën 10 (dhjetë) përqind të kësaj shume.

Për të shmangur çdo paqartësi, në mënyrë ilustruese jepet llogaritja e penalitetit përkatës në rastin e përfundimit të kontratës së koncesionit në fund të vitit të pestë.

$$A = 1,1 * B * C$$

A = Kompensimi (vlera e penalitetit që duhet të paguajë Autoriteti Kontraktues)

B = {Mesatarja e fitimit për 15 Vjet sipas Plan Biznesit [B= (F1+F2+.....+F15)/15] }

C= Vitet e mbetura në momentin e prishjes së kontratës nga ana e Autoritetit Kontraktues

10% = Penalitet

Në fund të vitit të 5 (pesë) aplikohet penalitet në masën:


$$A = (B * 10) + 10\% = B * 1,1 = \text{VLERA E PENALITETIT}$$

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

NENI 30

Zgjidhja me mirëkuptim

Nëse lind një mosmarrëveshje nga ose në lidhje me Kontratën (një "Mosmarrëveshje"), secila Palë do t'i japë një njoftim Palës tjetër në lidhje me këtë, pas të cilës Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të takohen menjëherë dhe në frymën e dialogut dhe mirëbesimit do të bëjnë përpjekje për të arritur një zgjidhje me mirëkuptim.



NENI 31

Eksperti

Në rast mosarritjeje të një zgjidhjeje me mirëkuptim sipas nenit më lart brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e njoftimit të parashikuar më sipër, çdo Mosmarrëveshje do t'i referohet një ekspert.

Me qëllim caktimin e ekspertit, i cili mund të jetë bazuar në llojin e mosmarrëveshjes, një ekspert financiar, teknik, ligjor etj. (i) Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të caktojnë secili një (1) ekspert brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas mbarimit të periudhës së lartpërmendur të zgjidhjes me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve dhe (ii) së bashku ekspertët përkatës do të caktojnë në mënyrë të arsyeshme ekspertin sa më parë që të jetë e mundur.


Vendimet e Ekspertit Teknik dhe Ekonomik do të jenë të barasvlefshme me rekomandimet ndaj Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit dhe nuk do të përbëjnë vendime detyruese mbi ta.

NENI 32

Gjykata kompetente

Nëse ndonjë Mosmarrëveshje nuk është zgjidhur me mirëkuptim ndërmjet Palëve dhe/ose nga Eksperti dhe ose ky i fundit nuk ka mundur të zgjidhë çështjen brenda një afati të arsyeshëm dhe/ose ekspertet e palëve nuk kanë mundur të caktojnë ekspertin sipas nenit më sipër brenda një afati të arsyeshëm, në çdo rast jo më të madh se 30 (tridhjetë) ditë, Mosmarrëveshja i paraqitet Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris për zgjidhje përfundimtare, ose nese te dyja palet bien dakord shprehimisht me shkrim per kete qellim Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë

Marrëveshja dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve si më poshtë do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë në pritje të vendimit në këto procedime dhe ky vendim, nëse është e nevojshme, do të përcaktojë nëse dhe kur mbarimi do të hyjë në fuqi. Megjithatë palët do të njohin e respektojnë



çdo vendim të tillë si, vendosja e masës së sigurimit apo detyrime të tjera deri sa vendimi të marrë formë të prerë.

Çdo mosmarrëveshje, konflikt ose pretendim që rrjedh nga ose në lidhje me këtë kontratë ose shkelje, mbarim apo pavlefshmëri e saj do të zgjidhet përfundimisht nga Arbitrazhit i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris, sipas rregullave procedurale në fuqi të tij (arbitrazhit). Gjuha që do të përdoret në gjykimin është gjuha angleze. Ligji material i aplikueshëm do të jetë ligji shqiptar.

NENI 33

Ligji i Zbatueshëm

Kjo Kontratë, hartohet e do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Koncensionari është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, duke përdorur të njëjtin mekanizëm si në rastin e negociimit të tarifës koncensionare, siç përcaktohet në këtë kontratë.

NENI 34

Gjuha e Kontratës, ndryshimet e kontratës

Kjo Kontrate hartohet e do të interpretohet dhe zbatohet në gjuhën shqipe. Të gjitha komunikimet dhe njoftimet ndërmjet Palëve në lidhje me të do të jenë në gjuhën shqipe.

Ndryshimet në kontratë bëhen nga Autoriteti Kontraktues dhe Koncensionari. Ndryshimet në kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktuese veçanërisht në rastet e mëposhtme:

(i) kur rrezikohet siguria kombëtare dhe mbrojtja e vendit, rrezikohet mjedisi, natyra dhe shëndeti i njerëzve.



(ii) kur humbet objekti i kontratës ose kur ekziston një pamundësi objektive për përdorimin e tij, në rastin e forcës madhore;

(iii) gjatë ndryshimit të kuadrit ligjor;

(iv) në raste të tjera që çojnë në ndryshimin e situatës reale ose ligjore për përdorimin e objektit apo ofrimin e shërbimeve, ose në realizimin e kontratës.

Ndryshimet e kushteve thelbësore të kontratës që bien në kundërshtim me sa parashikohet në dokumentacionin e procedurës konkurruese dhe/ose në vetë kontratën kërkojnë zbatimin e një procedure të re të dhënies së kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.

Pa shkelur dispozitat e neneve 32 dhe 33, të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat termi "kushtet thelbësore" u referohen në veçanti kushteve të cilat, nëse do të kishin qenë të përfshira në njoftimin fillestar të kontratës ose në dokumentacionin e tenderit, do të kishin bërë të mundur që ofertuesit të dorëzonin një ofertë në thelb të ndryshme, si dhe nëse ndryshimet do të kishin tejkaluar objektin e kontratës në atë masë që këto ndryshime do të përfshinin shërbimet që nuk mbulohen fillimisht.

Autoriteti Kontraktues kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave për të gjitha ndryshimet e planifikuara, të cilat ndikojnë ose krijojnë riskun e ndikimit direkt ose indirekt në buxhetin e shtetit ose në buxhetin e organeve vendore apo të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare siç përcaktohet nga ky ligj. Autoriteti Kontraktues njofton jo më vonë se 20 ditë Ministrinë e Financave për ndryshimet e bëra në kontratë në përputhje me këtë paragraf.

Pavarësisht parashikimeve të këtij neni, Autoriteti Kontraktues, mund të negociojë e miratojë me Konkensionarin, kohë mbas kohe, ndryshime të atilla, jo thelbësore dhe në interes të dy palëve, të tilla si, por pa u kufizuar në ndryshime të vogla eventuale të zonës së projektit, ndryshime të vogla të orareve të përcaktuara në projekt, të rinovimit të teknologjisë etj.

NENI 35

Njoftimet

Çdo njoftim ose komunikim tjetër nga një Palë për Palën tjetër, që kërkohet ose lejohet të bëhet sipas dispozitave të kësaj Kontrate: (i) do të bëhet në gjuhën shqipe; (ii) do të bëhet me shkrim;



(iii) do të dorëzohet personalisht (dorazi) ose do të dërgohet me postë rekomande të parapaguar ose me korrier në adresën e Palës tjetër që jepet më poshtë ose në ndonjë adresë tjetër të tillë, siç Pala tjetër do të kërkojë me njoftim ose do të dërgohet me mjete të tjera që lejojnë në mënyrë të padyshimtë konfirmimin e marrjes dhe (iv) shënohet në vëmendje të personit (ave) të caktuar më poshtë ose të ndonjë personi (ash) të tjerë siç Pala tjetër do ta kërkojë me njoftim.

Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë nga një Palë për Palën tjetër në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij Neni do të konsiderohet të jetë marrë nga Pala tjetër nëse dorëzohet dorazi në ditën që është lënë në adresën e asaj Pale (që mund të modifikohet herë pas here pas një njoftimi të arsyeshëm nga secila Palë për Palën tjetër), nëse dërgohet me postë rekomande të pararegjistruar ose me korrier dyzet e tetë (48) orë nga data e postimit ose nëse dërgohet me transmetim faksi, siç parashikohet më lart.

Për qëllime të komunikimit lidhur me zbatimin dhe interpretimin e kësaj kontrate palët caktojnë pikat e mëposhtme të kontaktit:

Për Koncesionarin

Bashkim Shalla

Tiranë,

Për Autoritetin Kontraktues sipas nenit 16 te Kontrates.

NENI 36

Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe ~~noteri~~. Kjo kontrate hartohet në 5 (pese) kopje të njëjta, nga 2 (dy) për secilën palë, dhe (1) nje kopje mbetet ne protokoll.

Titullari i Autoritetit Kontraktues

Shpëtim Gjika



Për Koncesionarin

TIS Holding LLC

Bashkim Shalla

Bashkim Shalla

On Track Innovations LTD

P Bashkim Shalla

Bashkim Shalla